

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

2780

Nr. _____ Prot

2307

Peshkopi, më _____.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 29

Datë: 22.07.2025 si dhe projekt-vendimin nr.08 Datë 14.07.2025

**“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2025”PËR
ALOKIM FONDE PËR INVESTIME**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Hir Elezi





2780/25/07/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.663/1 prot.

Peshkopi, më 24.07.2025

Lënda: Për vendimin nr.29, datë 22.07.2025 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR
KËSHILLIT TË BASHKISË DIBËR


DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.29, datë 22.07.2025 “Për një ndryshim në buxhetin e bashkisë Dibër për vitin 2025 “Për alokimin fonde për investime”, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 29 Datë 22 / 07 /2025

**“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2025”PËR ALOKIM
FONDE PËR INVESTIME”**

Në mbështetje të:

- - Ligji nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010 , “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin „
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”
- Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028 ”
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02. 2022 , per nje ndryshim ne udhezimin nr.23 dt 23.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”
- Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore” .
- Udhëzimin Plotesues Nr. 21 datë 07.07.2023 “Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”,

Udhëzimin Plotesues Nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025”,
Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **22.07.2025**, me 16 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

Në buxhetin e vitit 2025 të bëhen ndryshimet si më poshte:

1. Miratimin e ndryshimeve në tabelen e regjistrit te prokurimeve për vitin 2025 (Tabela nr 1 bashkelidhur).
2. Miratimin e ndryshimeve në tabelën e regjistrit te investimeve , për vitin 2025 (Tabela nr 1 bashkelidhur)
3. Miratimin e struktures buxhetore për vitin 2025 (për ndryshimet) sipas tabelës nr 1 bashkelidhur.

4. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Territorit Dibër.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Dibër
6. Vendimi u shpall me datë **22.07.2025**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak



PROJEKT-V E N D I M
Nr 08 Datë 11/07/2025

**PËR NJË NDRYSHIM NE BUXHETIN E BASHKISE DIBER PËR VITIN 2025 PER
ALOKIM FONDE PER INVESTIME**

Në mbështetje të:

- - Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin",
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore "
- Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028 "
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02. 2022 . per nje ndryshim ne udhezimin nr.23 dt 23.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore "
- Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ", i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore " .
- Udhëzimin Plotesues Nr. 21 datë 07.07.2023 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ", Udhëzimin Plotesues Nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025",

K E R K O J M E :

Në buxhetin e vitit 2025 të bëhen ndryshimet si më poshte:

1. Miratimin e ndryshimeve në tabelen e regjistrit te prokurimeve për vitin 2025 (Tabela nr 1 bashkelidhur).
2. Miratimin e ndryshimeve në tabelën e regjistrit te investimeve , për vitin 2025 (Tabela nr 1 bashkelidhur)
3. Miratimin e strukture buxhetore për vitin 2025 (për ndryshimet) sipas tabelës nr 1 bashkelidhur.
4. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Mbrojtjes dhe Zhvillimit te Territorit Diber.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Diber

PËR BASHKINË DIBËR:

Drejtor Juridik
Ismet SARACI

Drejtor M.ZH.T

Blerina MANREKA

Drejtor Ekonomik
Çeljeta ZUNA

DREJTOR SHERBIMESH

Bedri KAMBERI

Specialiste Buxheti
Erblina SELA

KRYETARI

Rahim Spahiu

Në mungesë dhe me porosi

Nënkryetari bashkisë

Lorenc CIBAKU



Soleta do të ketë edhe shufra shpërndarse poshtë dhe sipër me diametër 12 mm, gjithsej 58 copë me gjatësi secila 106 cm.

Theksojmë se te shtrati i ujit poshtë urës do të shtrohet një shtresë betoni C. 16/20 me trashësi 15 cm.

Kjo shtresë është llogaritur në preventiv edhe për pjesën ekzistuese të urës.

Gjithashtu është llogaritur që mbi soleten shtese të urës dhe në atë ekzistuese të bëhet një hidroizolim me dy duar bitum M-5 dhe mbi hidroizolim një shtresë betoni me trashësi $t = 8$ cm.

Për çdo problem firma zbatuese e objektit në fjalë, do të referohet projektit dhe konsultës me specialistët që kanë hartuar dokumentacionin për shtesën e kesajë ure.

Ju bejmë medije gjithashtu, se nga matjet dhe përlllogaritjet e bëra vlera e preventivit të punime për zgjerimin në urën e mesipërme rezulton **364 291** lek të reja pa tvsh, **10 928** lek fondi reserve, dhe **450 264** lek me tvsh vlera totale.

Bashkëngjitur këtijë relacioni dhe specifikimeve teknike keni preventivin e hartuar nga ana jonë.


Faleminderit për bashkëpunimin,

Hartoi
Bedri Shehu
Ermal Xhaka



Drejtori i Drejtorisë Shërbimeve

Bedri Kamberi



ORTOFOTO E VENDIT KU DO TE BEHET ZGJERIMI

I URES SE BETONIT NE FSHATIN PESJAKE

NJESIA ADMINISTRATIVE MAQELLARE



SPECIALISTI I DREJTORISE SHERBIMEVE

BEDRI SHEHU

DREJTORI I DREJTORISE SHERBIMEVE


BEDRI KAMBERI

PEREJA TERHORE E ZQJERIMIT JE URES

ESHATI PESTARJE SH 1:50


"N. ADM. MAQELLARE"

VITI 2025






140. BEDI JAKETI
SH 1:50
N. ADM. MAQELLARE
VITI 2025

PLAUSIBILITY OF THE WRECK SURVIVAL MESSAGE



17. ADM. MAOEFKARE



Harper:-
Bedford Ave

ST. 05/20
L=176

$$\frac{57.68}{20}$$


"PREGA TERPHORE, ESHAPATILAVE TE MRES PESMAE"

"SHALLA: 1:25"

"U. ADMINISTRATIVE"

"MAQELIAEE"

"BASHTIA DIBER"




HAEROI:
BEBE DHEHU
[Signature]
2021

GRAFIKU I PUNIMEVE

OBJEKTI : ZGJERIMI I URES BETONIT FSHATI PESJAKE
 NJESIA ADMINISTRATIVE MAQELLARE

NR	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	AFATET E REALIZIMIT TE PUNIMEVE : TRIDHJETE DITE									
				INDARE NE 10-DITOR									
				10 DITESHU PARE	10 DITESHU DYTE	10 DITESHU TRETE	10 DITESHU KATERT						
1	Prishje mure guri llaç çimentoje shpatullat e ures ne pjesen e poshtme.	m3	5.8										
2	Prishje mure betoni + solete betoni	m3	0.3										
3	Germim dheu me krah ne seksion te detyruar b> 1m, h=1,5 m toke e forte	m3	6.4										
4	Ndertim mure betoni ne lartesi C.25/30	m3	4.62										
5	Ndertim jastek betoni ne lartesi C.25/30	m3	0.25										
6	Strukture monolite betoni me çakull C.25/30 per solete.	m3	2.1										
7	Hidroizolim me dy duar bitum M-5 mbi soleten beton/arne	m2	21										
8	Shtrese betoni mbi hidroizolim C.16/20 me trashesi t = 8 cm	m3	1.68										
9	F. V. Hekur periodik me diameter me te madhe se 12 mm	ton	0.25										
10	Themel + xokol buto/betoni C.12/15 me 25% gure	m3	11.8										
11	Shtrese betoni C.16/20 t = 15 cm	m3	2.62										
12	Mbushje dhe ngjeshje me zhavorr lumi çdo 30 cm me makineri pas mureve.	m3	12										

HARTOI : ING. BEDRI SHEHU



PREVENTIVI

DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKTI: NDERTIMI I TREGUT AMBULANT

ISH - SHKOLLA BUJQESORE

NJESIA ADMINISTRATIVE PESHKOPI

BASHKIA DIBER

HARTOI:


BEDRI SHEHU

ERMAL XHAKA



DREJTORI DREJTORISE SHERBIMEVE

BEDRI KAMBERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE



PREVENTIV

OBJEKTI : NDERTIMI I TREGUT AMBULANT TEK SHESHI I ISH - SHKOLLES
BUJQESORE PESHKOPI.

Nr.	Nr.An.	PERSHKRIMI I MATERIALIT	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLEFTA
1	2.182	F.V. Konstruksione metalike te thjeshta	ton	2.78	144 389.90	401 403.92
2	2.401	Boje vaji mbi sipërfaqe metalike	m2	162	699.43	113 307.66
3	2.256/b	Mbulim çatie me panele sanduiç	m2	118	3 301.26	389 548.68
4	An	F.V. Lllamarine e zakonshme t =2 mm	m2	76	2800	212 800
		SHUMA:				1 117 060.26
		Fond rezerve 3%				33 511.80
		SHUMA:				1 150 572.06
		TVSH 20 %				230 114.41
		SHUMA TOTALE				1 380 686.47

Shënim: Çmimet në preventiv, janë marrë bazuar në manualin e preventivimit
VITI 2024

PREVENTIVOLI:
BEDRI SHEHU

DREJTORI
BEDRI KAMBERI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E SHERBIMEVE

Peshkopi, më 10 / 07 / 2025

RELACION SHPJEGUES
(SPECIFIKIMET TEKNIKE)

OBJEKTI: NDERTIMI TREGUT AMBULANT TEK ISH - SHKOLLA BUJQESORE
PESHKOPI

Bazuar në kërkesat e vazhdueshme të tregtareve ambulant tek ish - shkolla bujqesore Peshkopi, të cilët ka vite që tregëtojnë në kushte të pa përshtatshme, pa patur një vend të caktuar që të jetë i mbuluar dhe të ketë deri diku parametrat optimal për të trgëtuar produktet bujqesore ju informojmë si më poshtë:

Nga ana jonë u verifikua situata në vend, ku rezulton se tregtimi i produkteve bujqesore në këte shesh, behet në trotuare dhe pa kushtet minimale të tregimit për produktet e mesiperme,

Bazuar në këte fakt mendojmë se është i domosdoshem dhe emergjent, ngritja e një tregu ambulant te thjeshte, i mbuluar me panele sanduiçi, qe te jete i ndare me vende te veçanta per sejcilin tregtar, kjo bazuar edhe ne mundesine e fondeve qe ka Bashkia Diber.

Tregu ambulant do te vendoset ne sheshin e ish-shkolles bujqesore ngjitur me ndertesat e fisit Salxhaferri, me pamje nga sheshi, nga pjesa e trotuarit te unazes deri afer palestres te shkolles mesme profesionale aktualisht.

Ju bejme medije se tregu ambulant do te jete i perkohshem, pasi nga ana e specialisteve te Bashkise, duke siguruar me pare edhe fondet perkatese, do te gjendet nje vend tjeter me i pershtatshem, duke ngritur nje treg ambulant qe te plotesoje kriteret dhe parametrat e tjere si gjithe tregjet ne qytetet me te medha te vendit.

Ju bejme medije gjithashtu se tregu ambulant do te kete nje gjatesi rreth 51 ml, i ndare ne dy pjese duke lene ne mes nje hyrje prej 3 ml.

Eshte planifikuar dhe llogaritur ne preventive qe ne treg, do te shesin 28 tregtare, ku sejcili do te kete vendin e caktuar me nje gjatesi 180 cm.

Nga ana jone eshte menduar qe ndertimi do te behet me profila metalik tip kollone me permasa 10x10 cm duke i inkastruar ne asfalt, pa hapur gropa dhe themele, duke mos cenuar dhe demtuar edhe strukturen e sheshit te asfaltit.

Eshte planifikuar gjithashtu se sejcili tregtare do te kete tezgen e tij ne vendin e caktuar, te ndertuar me profila metalik dhe te shtruar poshte me llamarine te thjeshte.

Eshte menduar qe tregu do tejete i mbuluar me sanduic qe tregtaret te jene te mbrojtur nga agjentet atmosferik.

Theksojme se me ndertimin e ketije tregu ambulant te zgjidhen sado pak kerkesat e tregtareve ambulant, duke ju krijuar pak a shume kushte te pershtatshme dhe te favorshme, per tregetimin e produkteve bujqesore dhe te materialeve te tjera.


Ju bejme medije gjithashtu, se me ndertimin e ketije tregu te vogel ambulant, per kete pjese tregetaresh qe kane tregtuar vazhdimisht ne kete zone, do te krijohen mundesi te reja per mbarevajtjen e punes tyre, ne shitjen e produkteve te tyre si dhe do te lirohen te gjitha hapsirat publike ne kete zone, duke ua kthyer ato qytetareve.

Ju bejmë medije gjithashtu, se nga matjet dhe përlllogaritjet e bëra, vlera e preventivit të punime për tregun ambulant ne fjale rezulton **1 150 572** lek të reja pa tvsh, **33 511** lek fondi rezerve, dhe **1 380 722** lek me tvsh vlera totale.


Bashkëngjitur këtijë relacioni dhe specifikimeve teknike, keni preventivin e hartuar nga ana jonë.

Faleminderit për bashkëpunimin.



Hartoi
Bedri Shehu
Ermal Xhaka




Drejtori i Drejtorisë Shërbimeve
Bedri Kamberi



Adresa: Bulevardi "ELEZ ISUFI", Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935





PROJEKT - ZBATIMI


**OBJEKTI : ZGJERIMI I RRUGES DHE NDERTIMI I
TROTUARIT TE RI, TEK XHAMIA E VJETER, LAGJA :
TREG, PESHKOPI.**

(RRUGA RASIM FETAHU BARDULLA)

BASHKIA DIBER

HARTOI:

ING. BEDRI SHEHU

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Bedri Shehu', with a stylized flourish underneath.

Peshkopi mars 2025

**ORTOFOTO E VENDIT KU DO TE BEHET ZGJERIMI I RRUGES DHE
NDERTIMI I TROTUARIT TE RI, TEK XHAMIA E VJETER, LAGJA :
TREG, PESHKOPI. (RRUGA RASIM FETAHU BARDULLA)**

BASHKIA DIBER



ING. BEDRI SHEHU

[Handwritten signature]
25

PREVENTIV

MIRATOHET

ZV/KRYETARI

LORENC CIBAKU

**OBJEKTI : ZGJERIMI I RRUGES + NDERTIMI I TROTUARIT TE RI TEK
XHAMIA E VJETER, LAGJA: TREG, PESHKOPË
(RRUGA RASIM FETAHU BARDULLA)
BASHKIA DIBER**

	Nr.An	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
A		PUNIME PRISHJE				
1	2.430/1	Prishje murë guri, llaç çimentoje	m³	16,8	2.441	41015,184
2	2.426/5	Prishje murë betoni	m³	9,8	6302,05	61760,09
		SHUMA A:				102775,274
B		PUNIME GERMIMI				
1	2.5	Gërmim e mbushje dheu me krah kat III, për themele (plinta)	m³	2,05	1535,11	3146,9755
		SHUMA B:				3146,975
C		PUNIME BETON /ARME				
1	2.121	Brez beton/arme monolit C16/20	m³	4,2	17975,43	75496,806
2	114	Plinta e bazamente beton/arme monolite C12/15	m³	1,52	12.782	19 428,64
3	2.119	Trare beton/arme C16/20 h - 4m	m³	1,32	25 599,76	33.792
4	2.117	Kollona beton/arme monolite C16/20 h - 4m.	m³	1,24	25 049,08	31.061
5	2.698	Soletë beton/arme t =12 cm, C25/30	m³	2,64	26 703,07	70 496,10
6	2.130	Mure beton/arme t=20 cm	m³	7,2	17.975	129.423
7	2.166	F.V.Hekur periodik fi 6-10 mm	ton	0,584	124.147	72 501,84
8	2.166/1a	F.V.Hekur periodik fi >12 mm	ton	0,312	111.275	34 717,8
		SHUMA C:				466 917,18
D		PUNIME TE NDRYSHME				
1	2,414	F.V. Zgarra hekuri dekorative me konfiguracion mesatar.	ton	1,75	148 135,37	259 236,89

RELACION TEKNIK

Peshkopi mars 2025

OBJEKTI : ZGJERIMI I RRUGES DHE NDERTIMI I TROTUARIT TE RI, TEK

XHAMIA E VJETER, LAGJA : TREG, PESHKOPI.

(RRUGA RASIM FETAHU BARDULLA)

BASHKIA DIBER

Nisur nga situata e veshtirë ndër vite, në qarkullimin e aotomjeteve në rrugën e lagjes Llixha, me emrin Rasim Fetahu Bardulla, dhe konkretisht në pjesën e segmentit rrugor, në maloren ngjitur me varret e Teqës Peshkopi, ku automjetet nuk kanë shesh pamje dhe rruga është shumë e ngushtë ngaqë nuk ndërrohen dy automjete, nga studimi dhe verifikimi në vend i problematikës, u pa e domosdoshme dhe emërgjente, që të bëhet zgjerimi i rrugës në një distance prej 32 ml dhe ndërtimi i një trotuari të ri në gjatësinë 20 ml.

Bazuar në këtë fakt, nga ana jonë, për zgjidhjen e kësajë situate, që të përmiresohet sado pak qarkullimi në këtë segment rrugor, u hartua preventivi në vlerën **857 038 lek** pa tvsh dhe **1 028 446 lek** me tvsh, me qëllim që të miratohet fondi mësipërm për këto llojë punimesh.

Theksojmë se në preventiv janë planifikuar, punime, prishje, gërmime, betonime, vendosje zgarra hekuri në trotuar e tj.


Më konkretisht është planifikuar që të kryhen punimet e mëposhtme:

1. Nga objekti ish-këpucari ngjitur me varret e teqës Peshkopi, në një distancë prej 15 ml, do të priset muri i gurit me gjerësi 60 cm dhe lartësi 55 cm mbi trotuar dhe 20 cm me poshtë trotuarit , total lartësia e murit 75 cm dhe do te ndertohet nje brez betoni i armuar me kateër fije hekur fi 10 mm, me lartësi 20 cm.

2. Brezi i betonit do të jetë në një kuote me trotuarin ekzistues dhe në te,nga ana e varreve do të montohen zgarra mbrojtëse hekuri me një konfiguracion mesatar siç është parashikuar edhe në projekt.
3. Pas kësaj pjesë vjen segmenti i dytë me gjatësi 20ml, ku edhe në këtë pjesë do të prishet muri mbrojtës prej guri ekzistues, me gjëresi 60 cm dhe lartësi 50 cm + 20 cm poshtë kuotës asfaltit = 70 cm.
4. Edhe në këtë pjesë do të ndërtohet brez beton/arme mbi murin ekzistues, dhe pjesa e brezit të ri do të jetë në një kuotë me asfaltin e rrugës ekzistuese, me qëllim që të zgjerohet ajo me 60 cm, për të kaluar automjetet mbi brez beton/arme. Armimi i brezit do të bëhet me dy fije hekur 10 mm sipër dhe me katër fije hekur poshtë fi 12 mm. Stafat do të jënë çdo 25 cm me fi 8 mm.
5. Theksojmë se tek ky segment rrugor me gjatësi 20 ml, do të ndërtohet një trotuar i ri me gjëresi 110 cm, i cili do të dalë jashtë murit ekzistues, mbi pjesën e varreve të teqës, duke u mbështet mbi trarë dhe kollona beton/arme.
6. Gjithsej do të ndërtohen sipas projektit gjashtë trarë dhe gjashtë kollona beton/arme. Trarët do të kenë përmasat si në projekt me gjatësi 170 cm, gjëresi 30cm dhe lartësi 35 cm. Armatura e hekurit për traun do të jetë sipas projektit me dy fije fi 10 sipër dhe katër fije hekuri fi 16 mm poshtë. Stafat do të jenë fi 6 mm çdo 20 cm.
7. Kollonat do të jenë total gjashtë copë, me seksion katror me përmasa 30x30 cm. Hapsira nga aksi, kollone-kollone do të jetë 400 cm. Kollonat do të armohen me katër fije hekur fi 16 mm, dhe stafa fi 6 mm çdo 20 cm.
8. Kollonat do të mbështeten në themel me plinta beton/arme gjithsej cope gjashtë, aq sa janë edhe kollonat. Plintat do të kenë përmasat 70x70 x70 cm, të armuar poshtë me zgarrë hekuri me fije hekuri fi 12 mm.
9. Siç e theksuam edhe me lart, në gjithë këtë gjatësi prej 20 ml, mbi trarë dhe kollona do të ndërtohet trotuar i ri, me soletë beton/arme monolite me trashësi 12 cm dhe gjëresi 110 cm. Armimi i soletës do të bëhet me hekur fi 12 mm, 6 fi /ml sipas projektit dhe shpërndarse çdo 20 cm.
10. Me përfundimin e gjithë punimeve, në fund do të vendosen kangjellat (zgarrat mbrojtëse të hekurit), në qosh të trotuarit nga ana e varrezave.

		SHUMA D:				259 236,89
		SHUMA A+B+C+D:				832 076,3
		Fond rezervë 3%				24 932,2
		SHUMA :				857 038
		T.V.SH. 20%				171 407,7
		TOTALI:				1 028 446

PREVENTIVOI:
ING. BEDRI SHEHU



DREJTORI I SHËRBIMEVE
BEDRI KAMBERI



11. Pas përfundimit të këtyre punimeve, vjen pjesa e tretë e segmentit rrugor, me gjatësi totale 17 ml, që shkon deri tek ndërtesa dy katëshe. Theksojmë se tek ky segment rrugor, do të prishet muri mbajtës prej betoni, ngjitur me asfaltin e rrugës me gjatësi 12 ml, lartësi 70 cm dhe gjërësi 60 cm, i cili ka bllokuar pjesën e rrugës, si dhe do të prishet muri mbajtës prej betoni me trashësi 15 cm i cili është ndërtuar mbrapa shtëpisë private një kateshe, që ndodhet ngjitur me varrezat e teqës. Pasi të prishen këto dy mure dhe të zgjerohet segmenti rrugor i mësipërm, në këtë pjesë, dhe do të ndërtohet një murë i ri mbajtës beton/arme, ngjitur me shtëpinë private, i armuar me hekor dhe gjëresë 20 cm, për mbrojtjen e sajë nga automjetet.

12. Gjithashtu në pjesën e brendshme të trotuarit, nga ana e rrugës, meqenëse ka një dhëmbëzim prej 12 cm aq sa është trashësia e soletës trotuarit, në mënyrë që të mos ngjiten makinat në trotuar, do të vendosen mbrojtse, si tek shkolla Demir Gashi, por me lartësi 30cm, me tuba hekuri të kthyer në formë harku.

13. Me miratimin e këtij fondi për këto punime, operatori fitues i tenderi do të konsultohet me specialistët e Bashkisë që kanë hartuar projekt-preventivin, në mënyrë që, punimet të kryhen konformë parametrave të qarkullimit rrugor dhe sipas kushteve teknike të zbatimit.

Mendojmë se zgjerimi i segmentit rrugor të mësipërm, është i domosdoshëm dhe emergjent, duke parë edhe trafikun e makinave që kalojnë në këtë rrugë.

Me përfundimin e këtyre punimeve mendojmë, se do të zgjidhet sado pak, problematika e qarkullimit automobilistik në këtë segment rrugor, në mënyrë, që ai të jetë në parametrat optimal për qarkullimin e automjeteve.

HARTOI:

Bedri Shehu



Ermal Xhaka



PLANIMETRIA E VENDORSES PLINTAVE SHI 1:50

ZGJERIMI I PRUGES LAGIA: LIXHA (TREF)


DEKUPORI

PLANI I HOLLONAVE

TOTAL = 6 HOLLONA B/A
30x30 CM.


L = 20 ML.

30x30 CM.




PRERJA E PLINTIT
+ HOLLONA

PRERJA 1:1



ZGJERIMI HEKUR Ø 12 mm
200 12,5 CM.



HEKUR Ø 16 mm
4 COPE PER HOLLONA
L = 300 CM.

SHI 1:2

ING. BRESI CHEW

[Signature]

PLANIMETRIA E PLINTIT

COPE 6

GRAFIKU I PUNIMEVE

OBJEKTI: ZGJERIMI I RRUGES TEK XHAMIA E VJETER PESHKOPI

BASHKIA DIBER

NR	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	AFATI I REALIZIMIT TE PUNIMEVE : DYZET E PESE DITE					
				I NDARE NE MUJOR					
				MUAJ PRILLE	NDARE NE 10 DITORE		MUAJ MAJ	NDARE NE 10 DITORE	
1	Prishje murë guri, llaç çimentoje	m³	17						
2	Prishje murë betoni	m³	10						
3	Gërmim e mbushje dheu me krah kat III. për themele (plinta)	m³	2						
4	Brez beton/arme monolit C16/20	m³	4,2						
5	Plinta e bazamente beton/arme monolite C12/15	m³	1,52						
6	Trare beton/arme C16/20 h - 4m	m³	1,32						
7	Kollona beton/arme monolite C16/20 h - 4m.	m³	1,24						
8	Soletë beton/arme t =12 cm, C25/30	m³	2,64						
9	Mure beton/arme t=20 cm H=4m, C16/20	m³	7,2						
10	F.V.Hekur periodik fi 6-10 mm	ton	0,584						
11	F.V.Hekur periodik fi >12 mm	ton	0,312						
12	F.V. Zgarrja hekuri dekorative me konfiguracion mesatar.	ton	1,75						

HAJEROI:

ING. BEORE VUKETI

[Signature]

PREVENTIVI DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKTI: RRETHIMI I FUSHES MBETJEVE

NJESIA ADMINISTRATIVE PESHKOPI

BASHKIA DIBER

HARTOI:

BEDRI SHEHU

ERMAL XHAKA



DREJTORI DREJTORISE SHERBIMEVE

BEDRI KAMBERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE



PREVENTIV
OBJEKTI: NDERTIMI I RRETHIMIT TE FUSHES SE MBETJEVE
BASHKIA DIBËR
VITI 2025

N	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSI	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
		1. PUNIME DHEU				
1	2.5	Germim e mbushje dheu me krah kat III per themele, h=1.5m	m3	3.5	1 535.11	5 372.88
		SHUMA 1:				
		2. PUNIME MURAT. ME BLLOQE				
2	2.88	Mur me blloqe betoni 20cm, deri - 3m, me llaç.bastart. M-15	m3	51	9 195.17	468 953.6
		SHUMA 2:				
		3. PUNIME BETONI DHE B/A				
3	2,121	Breza b/a monolit C 16/20	m3	3.75	19 681.54	73 805.77
4	2,110	Themel e xokol b/betoni C - 12/15	m3	2.25	13 070.33	29 408.24
5	2.117/1	Kollona b/a, rrethimi.	m3	3.45	27 556.34	95 069.37
		SHUMA 3:				
		4. PUNIME SUVATIMI				
6	631-632	Suvatim me llaç çim M 25, në mure betoni.	m2	225	720.60	162 135
		SHUMA 4:				
		5. PUNIME TE NDRYSHME				
7	2.390/1	F.V. Dyer metalike llamarine	m2	10	6 449.81	64 498.10
8	2.166	F.V. Hekur betoni	ton	0.26	124 146.5	32 278.09
		SHUMA 5:				
		6. PUNIME BOJATISJE				
9	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gelqere	m2	225	76.37	17 183.25
		SHUMA 6:				
Shuma :						948 704.30
Fondi Rezervë 3.0%						28 461.12
Shuma :						977 165.42
Shuma TVSH 20%						195 433.08
Totali :						1 172 598.5

Hartoi
Ing. Bedri Shehu
[Signature]
2025

Drejtori i Shërbimeve publike
Bedri Kamberi
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

Peshkopi, më 09 / 07 / 2025

PROÇES - VERBAL

(KONSTATIMI)

+ SPECIFIKIMET TEKNIKE.

OBJEKTI: RRETHIMI I FUSHES MBETURINAVE.

BASHKIA DIBER.

I mbajtur sot më datë 10.07.2025, në prezencë të Z.Bedri Shehu, Ermal Xhaka dhe Fatos Jashari, në objektin Fusha e mbetjeve, Bashkia Dibër, lidhur me problematikat dhe gjëndjen faktike në të cilën ndodhet ajo.

Nga verifikimi në vend nga komisioni i mesiperm rezulton se:

Tek fusha e mbetjeve Bashkia Dibër, është i domosdoshem ndërtimi i një rrethimi të ri, me blloqe betoni, në mënyrë që të krijohet perimetri i sigurisë sipas rregullores për objekte te tilla, pasi nga pjesa e unazës ngjitur me fushën e mbeturinave, pesona të pa ndërgjegjshëm hedhin mbeturina vend e pa vend, duke krijuar një situatë jo të mirë dhe problematike.

Nga verifikimi në vend i objektit mësipërm, rezulton se fusha e mbetjeve, ka patur vetem nje pjese rrethimi me rrjete teli dhe plastike vende-vende, dhe ky rrethim eshte i abandonuar dhe i shkatrruar totalisht, dhe ne nje pjese te gjatesise se saje, ngjitur me unazen e madhe te qytetit, nuk ka të ndërtuar fare rrethim.

Theksojme se rrethimi ekzistues eshte demtuar me kalimin e viteve dhe nuk ekziston fare se bashku me porten e jashtme te hyrjes ne objekt.

Gjithashtu nga verifikimi në vend, rezulton se aktualisht në teritorin e fushes se mbetjeve, futen përsona të ndryshem, që nuk kanë lidhje me kete pune, duke krijuar situata të pakëndshme dhe konflikti.

Ju bëjme medije gjithashtu se, ngaqë nuk ekziston fare rrethimi se bashku me porten e jashtme, në teritorin e fushes mbetjeve, futen edhe bagëtitë e banorëve që janë me shtëpi përqark fushes mbetjeve.

Bazuar në verifikimin në vend si dhe faktet e mesiperme, eshte e domosdoshme qe te ndertohet nje rrethim i ri me kollona b/a dhe blloqe betoni qe ti rezistoje kohes me permasa 20x20x40 cm.pasi situata paraqitet emergjente, dhe nevoja për ndërhyrje është e domosdoshme.

Bazuar në këtë fakt, nga ana jonë u kryen matjet faktike në vend për rrethimin dhe u hartua preventivi përkatës me vlerë **1 172 598 lek me tvsh.**

Theksojmë se në preventiv është parashikuar ndërtimi i një rrethimi me blloqe betoni 20x20x40 cm, me kollona beton/arme çdo 3 m

Adresa: Bulevardi "ELEZ ISUFI", Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935

Kollonat beton/arme do të armohen me nga katër fije hekur fi 10 mm.

Rrethimi është llogaritur që të jetë me lartësi 220 cm.


Sipër rrethimit do të ketë brez betoni me trashësi 10 cm, i dalë në formë strehë në të dy anët e murit me nga 5 cm. Theksojmë se themelet dhe xoklatura e rrethimit është ekzistuese, përjashtuar një distance prej 21 m që është i demtuar dhe nuk ekziston fare.

Ju informojmë se në hartimin e preventivit nga ana jonë, për ndërtimin e rrethimit në fjalë, janë marrë çmimet e manualit sipas portalit "Sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim".

Bashkëngjitur këtij akt - konstatimi dhe specifikimeve teknike, është edhe preventivi përkatës me zërat e punimeve për ndërtimin e rrethimit, dhe krijimin e perimetrit të sigurisë në fushen e mbetjeve, Bashkia Diber.

Theksojmë se me ndërtimin e ri të rrethimit të fushes mbetjeve, do të krijohen kushte me të mira dhe të favorshme menaxhimi, për mbarëvajtjen e punës në këtë sektor, pasi pastrami i mbeturinave është i përditshëm dhe i domosdoshëm për përmirsimin e jetesës sa me të mirë të qytetarve.

Bedri Shehu




Ermal Xhaka



Drejtori i Drejtorisë Shërbimeve

Bedri Kamberi



Fatos Haxhari

